



PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **01.03.2024** me fillim në ora **10:10**. Këtë mbledhje e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Komunitete **z. Bajram Morina**.

Kryesuesi – Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Faleminderit për praninë tuaj. Përshëndetje për përfaqësuesit të KFOR-it, OSBE-së, për anëtarët e komitetit dhe gjithë të pranishmit. Njëkohësisht, ju njoftoj që mungon Zëvendëskryesuesi, Dusan Stojanovic, sepse ka disa angazhime familjare. Ky është takimi i dytë për vitin 2024, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

REND DITE

1. **Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023;**
3. **Informatë Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK);**
4. **Të ndryshme.**

1. **Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;**

Kryesuesi: Pas miratimit të rendit të ditës, a ka dikush ndonjë vërejtje apo sugjerim rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Me shumicë unanime procesverbali kalon.

2. **Shqyrtimi i raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023;**

Kryesuesi: Është pasqyrim i aktiviteteve dhe angazhimeve të Komitetit për Komunitete për periudhën janar - dhjetor 2023. Fokusi kryesor ishte përmirësimi i situatës së komunitetit joshumicë në komunën e Rahovecit, në fuqizimin e pozitës së tyre në fushën e arsimit - edukimit, gjithëpërfshirjes, përmirësimin e gjendjes së infrastrukturës, promovimin e vlerave të diversitetit etnik dhe kthimit të qëndrueshëm. Kemi realizuar vizita në shkolla dhe në lagje të komunitetit joshumicë për të diskutuar mbi gjendje të ndryshme rreth kushteve dhe problemeve sociale. Komiteti për Komunitete i ka bërë thirrje për diskutim drejtorive përkatëse. Drejtorinë e Bujqësisë, me të cilët është diskutuar tema e përmirësimit të kushteve për fermerët e komunitetit joshumicë. Me Drejtorinë e Shërbimeve Publike fokusi ka qenë në çështje të infrastrukturës, duke përfshirë ndriçimin e vendbanimeve të komuniteteve. Te Drejtoria e Shëndetësisë kemi diskutuar rreth çështjeve të kujdesit shëndetësor për komunitetin joshumicë. Te Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit, kemi diskutuar për mundësitë e rritjes dhe zhvillimit ekonomik për komunitetin joshumicë dhe kemi diskutuar që përmes iniciativave të ndryshme të përmirësojmë situatën ekonomike. Te Drejtoria e Arsimit është diskutuar intensivisht mbi mundësitë për përmirësimin e cilësisë në fushën e arsimit për komunitetin Rom, Ashkali, Egjiptianë. Pjesëmarrja aktive e komunitetit ka krijuar një platformë të përbashkët për bashkëpunim në mes autoriteteve arsimore dhe komunitetit për zhvillimin e arsimit në Komunën e Rahovecit. Diskutimet me ZKKK-në janë përqendruar në njohjen e sfidave që komunitetet joshumicë hasin në procesin e braktisjes dhe përfshirjes së tyre në shkolla. Tema tjera të fokusit kanë qenë edhe mbështetja me bursa për nxënësit dhe qëndrueshmëria financiare e qendrave të arsimit. Janë pasqyruar synimet për përmirësimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike të komunitetit joshumicë dhe mundësia mbi krijimin e platformave për promovimin e trashëgimisë kulturore, si dhe përfshirjen e tyre në ngjarje kulturore, lokale dhe ditëve memoriale. Komiteti për Komunitete ka marrë pjesë në tryeza dhe trajnime të ndryshme nga organizatat ndërkombëtare, qendrore

dhe lokale, për t'i diskutuar mundësitë e ngritjes së kapaciteteve në favor të komunitetit joshumicë. Ju faleminderit për vëmendjen! Gjithashtu, ju njoftoj që ky raport është shqyrtuar edhe në kuvend.

3. Informatë Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK);

Lendrit Qeli: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të komitetit, përfaqësues të OSBE-së, të UNMIK-ut. Po filloj me informatën që ZKKK së bashku me OSBE-në jemi në përpjekje për të krijuar kolegjiun për Zyret Komunale për Komunitete dhe Kthim. Një mekanizëm që ka rëndësi të veçantë në mbrojtjen e interesave të Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim, në 38 komuna. Ditëve në vazhdim do të thellohemi më gjerësisht me mënyrën se si do të funksionojë kolegjiuni. Kontaktet e para i kemi pasur edhe me asociacionin e komunave të Kosovës, ku është mirëpritur. Më lejoni t'ju raportoj që i kemi pasur disa intervenime të vogla në lagjen e epërme: dy policë të shtrirë, si kërkesë e vazhdueshme të përfaqësuesve nga radhët e komunitetit serb. Kemi vazhduar në zyrën tonë për aplikimin e MAPL-së për ndërtimin e shtëpive nga radhët e komuniteteve. Ne kemi asistuar në kompletimin e dokumentacionit. T'ju them të drejtën nuk jemi të kënaqur, sepse një komunikim i duhur me nivelin qendror do të ishte me rezultate shumë më të mira për komunën tonë. Ata po e hapin konkursin, mirëpo as një informatë të vogël nuk po e ndajnë me ZKKK-në. Informatat ne po i marrim përmes mediave dhe jo përmes komunikimit zyrtar dhe aplikimi po realizohet fizikisht në MAPL. Lehtësim i mirë do të ishte që të bëhet direkt prej komunave duke na bartur në përgjegjësi. E kemi nënshkruar edhe një memorandum bashkëpunimi dhjetor 2023, me organizatën “Advancing Together” për të implementuar projekte të ndryshme në kuadër të mbështetjes së organizatës së kombeve të bashkuara – misioni në Kosovë. Këtu, ne si zyre i kemi propozuar 4 projekte dhe të gjitha kemi arritur t'i mbrojmë në komisionin për pranimin e projekteve. Projekti i parë: Aktivizimi i qendrës së arsimit në lagjen e epërme dhe do të menaxhohet nga SHL -Kosova. Do të jetë një objekt brenda komunës dhe në këtë rast brenda ambientit të shkollës. Projekti i dytë ka të bëjë me fshatin Hoçë, aty ku është i koncentruar më shumë komuniteti serb. Kemi kërkuar inventarizimin e objektit rinor që gjendet aty. Projekti i tretë do të jetë për herë të parë në Komunën e Rahovecit. Do të jetë një kamp multietnik për të rinjtë e të gjitha nacionaliteteve, me qëllim të bashkëpunimit dhe socializimit mes vete. Projekti i katërt ka të bëjë me terrenin sportiv në fshatin Dobidol. Ky projekt do të koncentrohet në shkollë dhe do t'i ligj tri fshatra. Terreni do të jetë në bashkëfinancim nga ZKKK dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara me mision në Kosovë. Përafërsisht këto janë informatat, pa dashur të thellohemi më shumë për punët tona rutinore në zyrë, me procesin e riatdhesimit dhe kthimit të qëndrueshëm. Në fund, jemi duke i bërë përpjekjet tona në regjistrimin e popullatës, që qytetarët e komuniteteve ta përqafojnë procesin e regjistrimit, veçmas komuniteti serb, sepse në regjistrimin e fundit janë regjistruar shumë pak dhe në realitet dalin të jetën shumëfish më shumë.

Të ndryshme;

Merisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Ashtu siç e diskutuam edhe para mbledhjes, mendoj që mosdalja në terren është mangësi e madhe. Vizitat në terren duhet të ndodhin me patjetër, sepse në mungesë të informacionit, mendojnë gjithashtu edhe diskutimet në seancat që i mbajmë këtu. Si pasojë e kësaj, rendi i ditës është kaq i varfër dhe pa hapësirë të diskutimit. Përkundrazi, mendoj që rendi i ditës duhet të ketë më shumë pika. Për dalje në terren, mund ta shfrytëzojmë të njëjtën ditë të mbledhjes, meqë mbledhja nuk zgjatë shumë.

Ramë Berisha: Veç mos qeshni, sepse njeriu mund të gaboj gjatë raportimit të rasteve të ndryshme! I përshëndes pjesëmarrësit e këtij tubimi. Këtë mbledhje e hapi Kryesuesi Bajram Morina, i cili foli për shumë shërbime institucionale – komunale, arsim, shëndetësi, urbanizëm, siguri etj... Këtu është mirë se çka të flasim duhet të zbatohet, sepse këto mbledhje janë të plotëfuqishme. Kur është fjala për urbanizëm, ka fatkeqësi që i përjeton shoqëria, të cilat janë shoqërore apo natyrore. Në lagjen e epërme e kemi një përrockë që quhet “Lugë Xërxe” e cila gjatë sezoneve të ndryshme të vitit mbledh ujë shumë. Shtrihet prej 5km në formë lugore dhe kur të vie në tokë të rrafshët, janë disa familje majtas e djathtas të cilave iu ka bërë dëme materiale. Ekipi nga Rahovecit ka bërë një ndërhyrje, por përsëri ka nevojë që këto familje të kenë më shumë siguri.

Kryesuesi: Faleminderit Baca Ramë, nëse edhe dikush nuk ka ndonjë gjë në lidhje me pikën e fundit, po flas unë pak në lidhje me vizitat që do t'i realizojmë në vendbanime të ndryshme në shkolla dhe jo vetëm. Nëse jeni të pajtimit, që në po të njëjtën ditë ta mbajmë mbledhjen e rregullt dhe të dalim në terren së bashku.

Skender Hamza: Kryesuesi ndoshta duhet të konsultohet edhe me juve si anëtarë të komitetit, rreth rendit të ditës. Pas konsultimit, në rend dite mund të caktohet lokaliteti ku dëshironi ta vizitoni.

Kryesuesi: Atëherë, nëse pajtoheni të gjithë, vizitat do të realizohen në këtë mënyrë dhe patjetër që edhe në rend dite do të ceket vizita. Nëse nuk keni diçka tjetër, konstatoj që takimi është mbyllur dhe ju falënderoj për kontributi.

Mbledhja përfundoi: 10:45

Procesmbajtësi;



Albion Krasniqi

Kryesuesi i mbledhjes;



Bajram Morina



